Garancia dhe shërbimet e prodhuesit	Të ketë të përfshirë licensën me vlefshmëri për një periudhë 1 (një) vjecare. Gjatë kësaj periudhe nga momenti i aktivizimit prodhuesi të ofrojë përditësim të signatures nëpërmjet databazës mundësi për suport teknik për çështje teknike drejt suportit të prodhuesit (web portal, etj), akses në dokumentacion teknik.

* Në analizën e biznesit do të përcaktohen në detaje të gjitha kërkesat dhe realizimi i tyre

3. Sistem për filtrimin e fileve nga rreziqet e avancuara malware

Ky sistem i avancuar për zbulimin e kërcënimeve dhe analizën e malware do të përdoret për të identifikuar dhe neutralizuar kërcënimet e sofistikuara

Objektivat e përgjithshëm

- Të ketë funksionin e zbulimeve të kërcënimeve të avancuara si dhe të përdorë teknika të analizës së sjelljes për të zbuluar veprimet e dyshimta të softuerëve të dëmshëm në një mjedis të izoluar.
- Të kryejë identifikimin e kërcënimeve Zero-Day që nuk janë të njohura ende dhe nuk kanë nënshkrime në bazat e të dhënave të antivirusëve si dhe të përdorë teknologjinë AI.



- Të kryejë izolimin dhe karantinimin e skedareve që identifkohen si të dëmshëm për të parandaluar përhapjen e tyre.
- Të përdorë integrimin me platformat e tjera për të siguruar një mbrojtje të plotë dhe të koordinuar kundër kërcënimeve si dhe të automatizojë proceset e analizës dhe përgjigjes ndaj kërcënimeve, duke përmirësuar kohën e reagimit dhe duke zvogëluar ngarkesën e punës për ekipet e sigurisë.
- Të sigurojë raporte të detajuara për kërcënimet e zbuluara, duke përfshirë sjelljen e malware-it dhe ndikimin e mundshëm.
- Të përdorë metoda analitike për të ofruar njohuri të thelluara mbi tendencat dhe modelet e kërcënimeve.
- Të integrohet me pajisje të palëve të treta për të ofruar shërbime.
- Të përmirësojë aftësinë për të zbuluar kërcënimet komplekse që mund të mos zbulohen nga sistemet tradicionale të mbrojtjes.
- Të sigurojë mbrojtje në kohë reale duke analizuar dhe përgjigjur ndaj kërcënimeve në momentin që ato ndodhin.

Kërkesa	Përshkrim
Platforma	E tipit software appliance on premise në formën e makines virtuale.
Virtualizimi	Të mbështetë instalimin së paku në këta Hypervizore: VMware ESXi, Microsoft Hyper-V, Azure, KVM CentOS
Storage virtual	Me mbështetje për jo më pak se 10TB
Rrjeti	Min 3 x ndërfaqe virtuale
Menaxhimi	I bazuar në web dhe CLI, me opsion për një sistem të centralizuar të vecantë menaxhimi të vetë prodhuesit
Specifikime të sistemit	Duhet të skanojë të gjithë skedarët e ngarkuar për malware përpara se t'i bëjë të aksesueshëm për përdoruesit (ose të ruhen në serverin e skedarëve). Duhet të kryejë skanim te ngarkimet në kohë reale. Skaneri duhet të kërkojë nënshkrime të njohura të malware, si dhe anomali në metadatat dhe strukturën e skedarit që mund të tregojnë malware të turbullt. Skedarët që janë shënuar si me qëllim të keq dashes duhet të refuzohen dhe të mos përpunohen.



<p>Funksione dhe shërbime të sigurisë</p>	<p>Të ketë aftësi për:</p> <ul style="list-style-type: none">- Machine learning dhe AI për filtrim të shpejtë dhe skanim- Analizë statike dhe dinamike- Databaze të zgjeruar Antivirus- Filtrim Web- Anti-Phishing në kohë reale- Njohje të teknikave për detektim të fshehjes së malwarit nga sulmuesi- IPS- Command and Control- Callback- MITRE ATT&CK framework dhe shfaqje e teknikave dhe taktikave të përdorura nga sulmuesi i këtij frameworku <p>Të detektojë malwaret e tipeve të ndryshëm:</p> <ul style="list-style-type: none">- Adware- Backdoor- Botnet- Downloader.- Dropper- Exploit- Grayware- Hijack- Injector- Riskware- Rootkit- Trojan- Të mbrojtë nga rreziqe të njohura dhe të panjohura <p>Të nxjerrë URL-te nga kodet QR dhe të skanojë URL-te e perfshira në dokumenta dhe emaile</p> <ul style="list-style-type: none">• të mbështesë përdorimin e politikave YaRA
<p>Mënyrat e funksionimit dhe Integrimi me sistemet e tjera</p>	<p>Sniffing përmes protokolleve HTTP, FTP, POP3, IMAP, SMTP, SMB për jo më pak se 1Gbps trafik</p> <p>Komunikim me Proxy/gateway me klientë prot ICAP</p> <p>Komunikim me mail gateway përmes SMTP</p> <p>Komunikim me Network servers në Skanim përmes CIF e NFS dhe shërbime të data storage në cloud (AWS, Azure Blob etj)</p> <p>Dynamic Threat Intelligence DB update për malicious file checksum dhe URL</p> <p>Remote dhe secured logging me CEF servers dhe syslog servers</p>



	<p>Integrim me palë të treta tip JSON API ose ICAP</p> <p>Analizë statike e skedareve jo më pak se 10000 në orë</p> <p>Analizë dinamike e skedareve jo më pak se 150 në orë</p> <p>Njohje apriori e një sërë pajisjesh të sigurisë që dërgojnë të dhëna për analizim</p> <p>Funksionim për analizë paralele në disa ambiente</p> <p>Të mbështesë funksionimin në cluster të disa sistemeve njëkohësisht</p>
Limitimi i fileve, URL-ve dhe parametra të tjera	<p>Jo më pak se 500MB madhësi skedari, jo më pak se 4k karaktere të emrit.</p> <p>Jo më pak se 1000 nënskedarë në një skedar arkive</p> <p>Thellësia e skanimeve dhe timeout I analizës të jenë konfigurueshme</p>
Tipet e skedarëve dhe prapashtesat e tyre	<p>Të ekzekutueshme në Windows: .bat, .cab, .cmd, .dll, .exe, .js, .msi, .ps1, .vbs, wsf</p> <p>MS Office: doc/docm/docx, dot/dotm/dotx, .iqy, .one, .pot/potm/potx, .ppt, .pptm, .pptx, .ppam, .pps, .ppsm, .ppsx, .pub, .rtf, .sldm, .sldx, .xlam, .xls/xlsb/xlsm/xlsx/xtl/xltm/xltx</p> <p>eml, .pdf, .rl</p> <p>apk</p> <p>elf</p> <p>MacOS files: .app, .dmg, Mach-O</p> <p>htm, html, .lnk, Weblink</p> <p>7z, ace, arj, bz2, gz, iso, jar, kgb, lzh, rar, swf, tar, tgz, upx, xz, z, zip</p> <p>Të lejojë krijim e prapashtesave të personalizuar.</p>
Licensimi	<p>Të jetë i licencuar për jo më pak se 8 sisteme operimi të ndryshëm që do të shtohen dhe përdoren nga autoriteti kontraktor në ambientin e tij.</p> <p>Të mbështesë licensimin dhe përdorimin e jo më pak se 100 sistemeve të operimit në cloud. Të ketë të përfshirë licensen për shërbimet e sigurisë aktive të tipit të avancuar si Antivirus, IPS, Web Filtering, File Query, Industrial Security, SandBox Engine, Real-time Zero-Day Anti-Phishing dhe mbështetje nga prodhuesi me 24/7. Service me vlefshmëri për një periudhë 1 (një) vjetecare.</p>
Garancia dhe shërbimet e prodhuesit	<p>Gjatë periudhës së garancisë nga momenti i aktivizimit prodhuesi ofron përditësim të signatures nëpërmjet databazës së sigurisë kibernetike të tij online, update të sistemit të operimit dhe garanci për hardware, mundësi për suport teknik për ceshtje teknike drejt suportit të prodhuesit (web portal, telefon, etj), akses në dokumentacion teknik.</p>

* Në analizën e biznesit do të përcaktohen në detaje të gjitha kërkesat dhe realizimi i tyre



4. **Platforme Hardening kunder hakerimit te sistemeve operative PC dhe Serverat**

Zgjidhja e platformës System Hardening është një tërësi mjesh, teknikash dhe praktikash më të mira për të reduktuar vulnerabilitetet në aplikacionet e teknologjisë, sistemet, infrastrukturën, firmware-in dhe fusha të tjera. Qëllimi i System Hardening është të zvogëlojë rrezikun e sigurisë duke eliminuar vektorët e mundshëm të sulmeve dhe duke kondensuar sipërfaqen e sulmit të sistemit. Duke hequr programet e tepërta, funksionet e llogarive, aplikacionet, portat, lejet, qasjet, etj., sulmuesit dhe malware-t kanë më pak mundësi për të fituar terren brenda ekosistemit të IT-së.

Hardening i sistemeve kërkon një qasje metodike për të audituar, identifikuar, mbyllur dhe kontrolluar vulnerabilitetet e mundshme të sigurisë në të gjithë OSHEE Group sh.a. Ekzistojnë disa lloje aktiviteteve për Hardening e sistemit, duke përfshirë:

- Hardening i aplikacioneve
- Hardening i sistemit operativ
- Hardening i serverit
- Hardening i pikave fundore
- Hardening i bazave të të dhënave
- Hardening i rrjetit

Edhe pse parimet e Hardening të sistemeve janë universale, mjetet dhe teknikat specifike ndryshojnë në varësi të llojit të hardening që realizohet. Hardening i sistemeve është i nevojshëm gjatë gjithë ciklit të jetës së teknologjisë, nga instalimi fillestar, përmes konfigurimit, mirëmbajtjes dhe suportit, deri te çaktivizimi në fund të kohezgjatjes së pajisjes.

OSHEE kërkon të implementoj zgjidhjen e System Hardening duke reduktuar "sipërfaqen e sulmit", kombinimin e të gjithave, të metave dhe hyrjeve të pasigurta në teknologji, që mund të shfrytëzohen nga aktorët e kërcënimeve. Këto vulnerabilitete mund të ndodhin në shumë mënyra. Vulnerabilitetet e zakonshme të sipërfaqes së sulmit përfshijnë:

- Fjalëkalimet e paracaktuara (Default)
- Hardcoded passwords dhe kredencialet e tjera të ruajtura në skedarë me tekst të thjeshtë
- Vulnerabilitetet e firmware dhe softueret që nuk janë përditësuar
- Mungesa e kontrolleve të aksesit me privilegje.
- Konfigurimet e dobëta të BIOS-it, firewall-ëve, portave, serverëve, switch-ëve, router-ëve ose pjesëve të tjera të infrastrukturës.
- Trafiku i rrjetit ose të dhënat në gjendje statike që janë të paenkriptuara ose të enkriptuara në mënyrë të pamjaftueshme
- Etj.



OSHEE kërkon vleresimin në mënyrë të vazhdueshme të system Hardening kundrejt burimeve duke përdorur standardet e industrisë nga NIST, Microsoft, CIS, DISA, etj.

Nepermjet System Hardening OSHEE kërkon që të realizoj analizat si mëposhte:

1. **Auditim te sistemeve ekzistuese**
2. **Krijimin e një strategji për Hardening të sistemeve**
3. **Përditësoni vulnerabilitetet menjëherë**
4. **Hardening i rrjetit**
5. **Server hardening**
6. **Endpoint hardening**
7. **Application hardening**
8. **Database hardening**
9. **Operating Systems (OS) hardening**
10. **Eliminimin e llogarive dhe privilegjet e panevojshme**

Përfitimet nga Systems Hardening

Systems Hardening kërkon përpjekje të vazhdueshme, përfitimet e këtij sistemi do të shpërblehen në mënyrë thelbësore në të gjithë strukturën e OSHEE-se përmes:

- **Funksionalitet i përmirësuar i sistemit:** Më pak programe dhe funksionalitet do të thotë më pak rrezik për probleme operative, konfigurime të pasakta, inkompatibilitete dhe kompromise.
- **Siguri e përmirësuar:** Një sipërfaqe e reduktuar e sulmit përkthehet në një rrezik më të ulët për shkelje të të dhënave, qasje të paautorizuar, hacking të sistemeve ose malware.
- **Përputhshmëri dhe auditim të thjeshtuar:** Më pak programe dhe llogari të shoqëruara me një mjedis më pak kompleks do të thotë se auditimi i mjedisit do të jetë zakonisht më i qartë dhe më i thjeshtë.

Qellimi i shërbimeve përmes përdorimit të një platforme për hardening kundër hakerimit të sistemeve operative për PC dhe servera është vendosja dhe përdorimi i praktikave me të mira për konfigurimin e pajisjeve kompjuterike dhe sistemeve operative në mënyrë të sigurtë referuar standardeve të njohura ndërkombetare si CIS, përmes aplikimit të imazheve virtuale të sigurta apo mjeteve të tjera, dhe vendosja e përdorimi i praktikave me të mira të kontrollit për përmirësimin e statusit të përgjithshëm të mbrojtjes kibernetike, referuar standardeve të njohura ndërkombetare si CIS. Këto praktika dhe sete konfigurimesh duhet të ndihmojnë që të paraqesin statusin e



konfigurimeve dhe kontrolleve te sigurise dhe te sherbejne si reference dhe udhezues per minimizimin e dobësive te sigurisë dhe të mbajnë përputhshmërinë me standardet e industrisë.

Platforma e perdorur per sherbimet e hardening duhet te jete e instalueshme ne ambjentin e klientit ne forme server-klient/agjent dhe te ofroje:

- Benchmarke (praktika konfigurimesh standarde te sigurise) per nje numer te gjere prodhuesish dhe sistemesh operative
- Sete konfigurimesh standarde te sigurise per sistemet operative
- Versione periodike te perdituara te tyre
- Skanim te automatizuar per vleresimin e sigurise
- Te jete kompatible me nje game te gjere sistemesh operative per desktop, workstations, servera dhe pajisje te tjera kompjuterike, perfshire sistemet operative Windows, Linux, Unix
- Te jete e integrueshme me sisteme te tjera te menaxhimit IT
- Te kontrolloje qe sistemet te jene te konfiguruar sipas praktikave me te mira te sigurise
- Te krahasoje konfigurimet aktuale me standardet si CIS per vleresim te situates
- Te beje vleresimin e konfigurimeve te sigurise ne baze te pikeve, duke mbeshtetur me politikat e sigurise se organizates.
- Te gjeneroje raporte konformiteti ne formate te ndryshme si HTML, text, excel, XML format
- Te jete fleksibel ne perdorim sipas madhesis se infrastruktures pa kufizime specifike
- Te kete mundesi per perdorimin web dhe CLI
- Metoda per aksesimin ne largesi te pajisjeve
- Te mundesoje pjemarrjen ne komunitete te eksperteve te sigurise per ndarjen e njohurive dhe eksperiencave per konfigurimet e sigurise
- Te mundesoje kontroll më të madh mbi të dhënat dhe zgjidhje per shperndarjen e tyre në mënyrë anonime
- Te mundesoje krahasime me mesataren e industrisë.
- Te ofroje fleksibilitet ne lidhje me konfigurimet e sigurise dhe kontrollet e statsuit te sigurise ne lidhje me strukturen organizative.
- Te kete mundesi per percaktimin e përdoruesve në role të ndryshme, si dhe role të veçanta administrative dhe joadministrative dhe ndjekjen e progresit dhe statusit te përdoruesve e punonjesve, bashke me ngarkimin e dokumentacionit perkates.
- Te mundesoje per gjurmimin e vlerësimeve të shumta të njëkohshme në të njëjtën organizate.
- Te mundesoje vlerësime ne baze pyetesoresh.
- Te mundesoje raporte mbi diferencat ne konfigurimet e sigurise
- Te mundesoje informacion mbi pajisjen kompjuterike mbi te cilen kryhet skanimi I sigurise, se bashku me kriteret e vleresimit, rekomandimet dhe natyren e tyre automatike apo manuale.
- Sherbimet e hardening mbi platforme me te drejte perdorimi per jo me pak se 1(nje) vit.

Suporti dhe implementimi



- Ne zgjidhje të përfshihet suport për update të software për 1 vit të ofruar nga Operator Ekonomik në bashkpunim me prodhuesin e zgjidhjes.
- Instalimi, konfigurimi dhe testimi duhet të bëhet nga Operatori Ekonomik, zgjidhja duhet të dorëzohet e plotë (Turnkey Solution).
- Zgjidhja të përfshijë akses direkt në qendrën e autorizuar për: hapje dhe ndjekje te case, informacion në forume, njoftime të reja rreth zgjidhjes, dokumenta online.

* Në analizën e biznesit do të përcaktohen në detaje të gjitha kërkesat dhe realizimi i tyre.

5. F.V Platforme te integruar për menaxhimin e rrezikut kibernetik per zbulim dhe menaxhim të dobësive

Ofrimi i nje platforme te integruar për menaxhimin e rrezikut kibernetik per zbulim dhe menaxhim të dobësive në të gjithë mjediset e IT, duke përfshirë cloud, pajisjet e lidhura dhe aplikacionet e webit me aftësi per skanimin të dobësive, monitorimit të përputhshmërisë dhe analizës së rrezikut për të ndihmuar menaxhimin e rreziqeve në mënyrë më të efektshme dhe proaktive. Rezultat I perdorimit te ketij sistemi jane dobesite e zbuluara dhe propozime te detajuara per eliminimin e ketyre dobesive. Sistemi duhet te mundesoje kryerjen e vleresimit te automatizuar te infrastruktures duke imituar perpektiven e nje perdoruesi keqdashës, per te zbuluar dobesite pa ndikuar ne ndrepreje te trafikut dhe sherbimeve.

- Menyra e ofrimit: E instalueshme ne ambjentin e klientit. Te mundesoje edhe implementimin ne cloud si sherbim dhe menyren hibride
- Platforma duhet te kryeje skanim te vazhdimshëm te dobësive të rregullta dhe automatike për të identifikuar dobësitë në sistemet, rrjetet dhe aplikacionet e organizatës.
- Te mbështet mjedise lokale, cloud dhe hibride, duke skanuar për dobësi në serverë, pajisje endpoint.
- Te ofroje alarme të personalizueshme që informojnë në kohë reale për ngjarjet e sigurisë, duke i dhënë mundësi ekipeve të reagojnë shpejt.
- Te përmbushjen e kërkesave të pajtueshmërisë për industrinë HIPAA, ISO 27001, PCI DSS dhe ofron raporte të detajuara të sigurisë.
- Te ofroje skanim automatik dhe të thelluar të aplikacioneve web për të identifikuar vulnerabilitetet që mund të shfrytëzohen nga sulmuesit.
- Te ofroje skanime dhe zbulimin e vulnerabilitetet e njohura si SQL Injection, Cross-Site Scripting (XSS), dhe shumë lloje të tjera të sulmeve të aplikacioneve web.



- Gjeneron raporte të hollësishme që përmbajnë informacion të qartë për vulnerabilitetet e gjetura, rrezikun e tyre dhe rekomandime për zgjidhjen e tyre.
- Te ofroje mjete për të menaxhuar vulnerabilitetet e identifikuara, duke përfshirë klasifikimin dhe priorizimin e tyre bazuar në rrezikshmërinë.
- Te kryej skanime të detajuara pa ndikuar në performancën ose disponueshmërinë e aplikacioneve web.
- Te skanoje aplikacione web, përfshirë ato që përdorin SPA (Single Page Applications) dhe API të bazuara në REST dhe GraphQL.
- Te Mbështesi skanimet e autentifikuara për të ofruar një analizë më të thellë të aplikacioneve që kërkojnë autentifikim për qasje në pjesë të veçanta.
- Zgjidhja ne menyre opsionale te mundesoje identifikojte dhe analizoje vulnerabilitetet e pajisjeve dhe sistemeve OT, duke ndihmuar në prioritizimin e masave të sigurisë, segmentimin e rrjetit për të kufizuar lëvizjen laterale të sulmuesve brenda rrjetit OT, identifikimin dhe inventarizimin e pajisjeve dhe sistemeve brenda rrjetit, për të siguruar një pamje të plotë të infrastrukturës, Te analizoje trafikun e rrjetit për të zbuluar anomalitë dhe për të identifikuar sjelljet e pazakonta që mund të tregojnë për një sulm duke integruar të dhënat e sigurisë OT me platformat e sigurisë së IT-së, për të ofruar një pamje të plotë të rreziqeve në mjediset hibride IT/OT.
- Te ofroje menaxhimin e të dhënave të sigurisë në mënyrë të centralizuar me opsionet e vendosjes në on-prem ose hibride, duke përmbushur kërkesat komplekse të vendosjes.
- Te kombinoje të dhënat e vulnerabiliteteve dhe inteligjencën e kërcënimeve për të vlerësuar probabilitetin e shfrytëzimit të një vulnerabiliteti dhe kritikalitetin e aseteve përkatëse.
- Te ofroje se paku 400 dashborde të parakonfiguruar dhe raporte të personalizueshme që ofrojnë pasqyrë të menjëhershme në përputhjen e sigurisë, efektivitetin dhe rrezikun.
- Te përdori një përzierje sensorësh aktivë, agjentësh, monitorim pasiv të rrjetit dhe integritete CMDB për të zgjeruar mbulimin e skanimeve dhe për të reduktuar pikat e verbëra të vulnerabilitetit.
- Te përdori detektimin pasiv të vulnerabiliteteve, për të eliminuar pikat e verbëra dhe për të zbuluar ndryshimet e aseteve.
- Te krahasojte të dhënat e vulnerabiliteteve, inteligjencën e kërcënimeve dhe shkencën e të dhënave për të krijuar një vlerësim të rrezikut që ndihmon në identifikimin e vulnerabiliteteve me ndikimin më të lartë për organizatën.
- Te ofroj raporte dhe kontrole të paracaktuara për përputhshmëri me standardet e industrisë si CERT, NIST, DISA STIG, DHS CDM, FISMA, PCI DSS, HIPAA/HITECH, dhe shumë të tjera.



- Kjo platforme duhet te mbeshtet nga prodhuesi mbi ekspozimin kibernetik, analiza të shkencës së të dhënave dhe këshilla sigurie për të përditësuar dhe mbrojtur organizatën kundër kërcënimeve të reja.
- Zgjidhja te ofroje ne menyre opsionale nje modul sherbimi per analizen e rrjedhes se sulmeve potenciale, duke korreluar te dhenat e vulnerabiliteteve te zbuluara dhe duke rritur keshtu nivelin e mbrojtjes preventive.
- Te ofroje ne menyre opsionale nje modul sherbimi per simulimin e sulmeve me qellim validimin e vazhdueshem te efektivitetit te kontroleve te sigurise permes sulmeve te simuluar qe nuk cenojne vazhdimesine normale te punes.
- Te mund te integrohet të me platformat e sigurisë së IT-së, për të ofruar një pamje të plotë të rreziqeve në mjediset hibride IT/OT.
- Te Integrohet lehtësisht me mjetet e DevOps dhe CI/CD për të ofruar skanim të vazhdueshëm të aplikacioneve gjatë zhvillimit dhe vendosjes së tyre.
- Te mbështesi automatizimin e proceseve të menaxhimit të vulnerabiliteteve përmes një API të dokumentuar dhe integrimi të parakonstruktura për skanimin me kredenciale, SIEM, SOAR, sistemet e menaxhimit të service desk dhe patching
- Te integrohet me sisteme te jashtme per kryerjen e simulimit te sulmeve.
- Te integrohet me modulën e kryerjes se testimit te penetrimeve permes plugins perkates, duke ofruar shkrimin, testimin dhe kryerjen e kodeve te sulmeve me qellim testimin e dobesive te sigurise, zbulimin e rrjetave, kryerjen e sulmeve, perhapjen e sulmeve dhe detektimin e shmangieve, permes fazave te ndryshme te detektimit dhe skanimit, zbulimit te dobesive, sulmit, perhapes, fazes pas sulmit etj, dhe ne zona te ndryshme te sigurise perfshire kredencialet.

Zgjidhja e platformës Software per Menaxhimin dhe Validimin e Ekspozimit në Sigurinë Kibernetike synon forcimin e mbrojtjes së infrastrukturës kritike dhe jo vetëm, duke vlerësuar në mënyre konsistente kontrollet e sigurisë dhe mbrojtjes të aplikuara. Output i këtij moduli software duhet të jenë dobesitë e zbuluara dhe propozime të detajuara për mitigimin e këtyre dobësive. Zgjidhja e propozuar duhet të kryejë vlerësim të automatizuar të infrastrukturës duke imituar prespektivën e një përdoruesi keqdashës, për të zbuluar dobesitë e sistemit pa ndikuar në ndërpreje trafiku dhe shërbimet aktuale.



Figure 1-Testimi i sigurisë




Figure 2-Fushat në testimin e sigurisë

Testimi i Sigurisë në Rrjet

- Zgjidhja duhet të skanojë dobësitë e shfrytëzueshme, do t'i shfrytëzojë ato sipas kërkesës dhe do të lëvizë në rrjet, duke sfiduar dhe vërtetuar problemet e sigurisë dhe sjelljen kibernetike.



- Zgjidhja duhet të përfshijë një gamë të larmishme sulmesh. Të gjithë skenarët e sulmit do të shfaqen sipas strukturës MITRE ATT&CK.
- Zgjidhja duhet të jetë në gjendje të sulmojë të gjithë komponentët e rrjetit brenda range-it të paracaktuar IP duke ekspozuar dobësitë dhe duke i shfrytëzuar ato në kohë reale.
- Zgjidhja duhet të vazhdimisht të përgjojë kredencialet nga trafiku i rrjetit në range-in e parapërcaktuar të IP.
- Zgjidhja duhet të përpiqet të marrë kredencialet nga brenda rrjetit të testuar duke përdorur metoda të ndryshme.
- Zgjidhja duhet të përpiqet të kryejë lëvizje në rrjet brenda mjedisit të testuar, duke mbledhur informacione të vlefshme dhe duke i migruar ato përsëri në zgjidhje.
- Zgjidhja nuk duhet të kërkojë asnjë informacion paraprak për të ekzekutuar një test të kutisë së zezë (blackbox) - platforma duhet të fillojë testin pa kredenciale ose njohuri të hollësishme të rrjetit të testuar dhe do të kryejë sulmin duke përdorur vetëm gjetjet nga vetë testi
- Zgjidhja duhet të ketë aftësinë për të ekzekutuar një test të synuar në rrjetin organizativ – psh të testojë fortësinë e fjalëkalimeve në shumë hoste dhe domains, të provojë të vendosë kod në host, etj.

Testimi i Sigurisë në Server Side Application

- Zgjidhja duhet të jetë në gjendje të sulmojë të gjithë serverat brenda brenda range-it të paracaktuar IP duke ekspozuar dobësitë dhe duke i shfrytëzuar ato në kohë reale
- Zgjidhja duhet të jetë në gjendje të sulmojë mjedisin e Active Directory brenda range-it të paracaktuar IP duke ekspozuar dobësitë dhe shfrytëzimin e tyre në kohë reale, duke përfshirë extractimin e grupeve dhe përdoruesve të AD dhe krijimin e llogarive të administratorit të domenit, nëse është e mundur
- Zgjidhja duhet të përdorë teknika të ndryshme për të marrë akses në një endpoint/ server, duke mbledhur informacion të vlefshëm dhe duke përdorur atë informacion për lëvizje në rrjet dhe për përshkallëzimin e privilegjeve

Testimi i Sigurisë në Client Side Application

- Zgjidhja duhet të jetë në gjendje të sulmojë të gjitha pikat përfundimtare brenda range-it të paracaktuar IP duke ekspozuar dobësitë dhe duke i shfrytëzuar ato në kohë reale
- Zgjidhja duhet të jetë në gjendje të skanojë dhe ekstraktojë të gjithë hostet në range-in e parapërcaktuar të IP
- Identifikimi i çdo pajisje IT brenda range-t të paracaktuar të IP – duke përcaktuar Sistemin e Operimit të është instaluar
- Zgjidhja duhet të përpiqet të ngarkojë kod në hostet ekzistuese për të marrë informacione që qëndrojnë brenda hosteve dhe për të testuar Antivirus dhe End Point Security
- Zgjidhja duhet të përdor një host me platformën e instaluar në të për tu lidhur dhe ekzekutuar testin për disa orë pa ndonjë parakusht për ambientin e testuar



- Zgjidhja duhet të ketë aftësinë që të marri kredenciale si një pikënisje ose të shenjojë hoste të veçanta si asete kritike dhe të mund të konfigurohet që platforma të përqendrojë përpjekjet në këto asete të shënuara

Testimi I Sigurisë në Software

Testimi i sigurisë është i nevojshëm të bëhet në fazat fillestare të ciklit jetësor të zhvillimit të software-it sepse nëse kryejmë testimin e sigurisë pas fazës së ekzekutimit të software-it dhe fazës së vendosjes së SDLC, kjo do të na kushtojë më shumë.

Në figurë tregohet hapi se kur duhet të realizohet penetration testing & Vulnerability scanning.




Figure 3 - FAZA SDLC

- Zgjidhja duhet të jetë në gjendje të sulmojë të gjitha bazat e të dhënave brenda range-it të paracaktuar IP duke ekspozuar dobësitë dhe duke i shfrytëzuar ato në kohë real
- Zgjidhja duhet të jetë në gjendje të sulmojë të gjitha source code brenda range-it të paracaktuar IP duke ekspozuar dobësitë dhe duke i shfrytëzuar ato në kohë real

Të përgjithshme

- Platforma e ofruar duhet të ketë aftësi për të paraqitur një shpjegim të hollësishëm të shkakut rrënjësor të cenueshmërisë dhe mënyrës së rregullimit të kësaj dobësie - duke u përqëndruar kështu në riparimin sa më të shpejtë
- Platforma duhet të jetë në gjendje të kryejë skanim të cenueshmërisë (vulnerability assesment) si një aftësi më vete

Testimet



- Platforma duhet të ofroj që testet të mund të ekzekutohen nga distanca (remote) duke përdorur VPN që është instaluar në kompjuter fizik në rrjetin që do testohet.
- Testi mund të ekzekutohet duke vendosur platformën në një kompjuter portativ / kompjuter ose server të lidhur me mjedisin e testuar pa ndonjë parakusht nga mjedisi i synuar
- Zgjidhja e automatizuar Pentest duhet të jetë në gjendje të kryejë një test pa vendosur agjentë në rrjetin e testuar

Raportimet

- Çdo veprim i kryer nga zgjidhja (i suksesshëm ose jo) duhet të regjistrohet dhe të jetë e paraqitur në rend kornologjik në raportin e plotë.
- Zgjidhja duhet të përfshijë në një kartelë: qëndrueshmërinë, dobësitë kryesore, rekomandimet për marrje masash si dhe vektorët e plotë të sulmit.
- Çdo test duhet të numerizohet dhe duhet të tregojë 10 ekzekutimet e fundit që ndodhën në të njëjtin rrjet.
- Raporti duhet të përfshijë veprimet për marrje masash për të përmirësuar gjendjen e sigurisë së kompanisë.
- Raportet e skanimit të cënueshmërisë (vulnerability assessment) duhet të jenë pjesë e marrjes së masave të zgjidhjes.

1.2 Licensimi

- Zgjidhja duhet të jetë e licensuar minimumi për 2500 makina fundore (endpoints)
- Licensimi të jetë i pajtueshëm për një periudhë një (1) vjecare.

1.3 Suporti dhe implementimi

- Në zgjidhje të përfshihet suport për update të software për 1 vit të ofruar nga Operatori Ekonomik në bashkpunim me prodhuesin e zgjidhjes.
- Instalimi, konfigurimi dhe testimi duhet të bëhet nga Operatori Ekonomik, zgjidhja duhet të dorëzohet e plotë (Turnkey Solution).
- Zgjidhja të ofroje mundësi për komunikim me chat, web, telefon dhe email me qendrën, suportin e autorizuar të vet prodhuesit të pajisjes.
- Zgjidhja të përfshijë akses direkt në qendrën e autorizuar për: hapje dhe ndjekje të case, informacion në forume, njoftime të reja rreth zgjidhjes, dokumenta online.



6. F.V Sistem per mbrojtjen e te dhenave nga rrjedhja dhe perdorimi i paautorizuar per 300 perdorues (DLP)

Qëllimi:

Ky software do të përdoret për të mbrojtur informacionin kritik nga aksidentet, aktivitetet e paautorizuara ose keqpërdorimi nga përdoruesit e brendshëm dhe atyre të jashtëm.

Objektivat e përgjithshëm

- Të ketë qëllim të mbrojtë informacionin e ndjeshëm, përfshirë informacionin personal, regjistrat financiarë dhe pronën intelektuale, nga qasja e paautorizuar, humbja, ose vjedhja.
- Të përmbushë rregulloret dhe standartet si GDPR, HIPAA, dhe PCI-DSS duke siguruar trajtimin dhe mbrojtjen e duhur të informacionit sensitiv.
- Të zbulojë dhe parandalojë lëshimet e të dhënave përmes kanaleve të ndryshme, përfshirë emailin, ruajtjen në cloud, dhe mediat e largueshme, duke monitoruar dhe kontrolluar transferimet e të dhënave.
- Të ofrojë mjete për të zbuluar dhe reaguuar ndaj mundësive të shkeljeve të të dhënave ose shkeljeve të politikave në kohë reale, duke mundësuar veprime të shpejta për korrigjim.
- Të mundesojë monitorimin e aktiviteteve dhe sjelljet e përdoruesve për të identifikuar veprimet e rrezikshme dhe për të zbatuar efektivisht politikat e mbrojtjes së të dhënave.
- Të lejojë zbatimin e politikave të mbrojtjes së të dhënave bazuar në përmbajtje, kontekst, dhe sjelljen e përdoruesve për të siguruar qëndrueshmëri dhe efektive të të dhënave.
- Të ofrojë mundësi për detajimin e raportimit dhe auditimit për të ndjekur aktivitetet e mbrojtjes së të dhënave në përputhshmëri me politikat, si dhe incidentet e sigurisë.

Kërkesa	Përshkrim
Platforma	E tipit software me arkitekture Server-Client. Server software i qendërzuar (Server), kompatibel për instalim në sistem operativ MS Windows Server ose ekuivalent. Serveri është përgjegjës për të gjithë databazen e të dhënave të aktivitetit dhe sigurisë të grumbulluara nga agjenti (Client), si edhe për pjesën menaxheriale dhe raportimit.Me agjentë të formës kliente (Client) për endpoint, kompatibel me sistemet operative Windows, MacOS dhe me kerkesa minimale për përdorimin e resurseve hardware.
Funksionet	Aplikacioni duhet të ofrojë analizim të sjelljes së përdoruesve si edhe të merret pamje në kohë reale të statusit dhe të aktiviteteve të dyshimta që mund të jenë duke ndodhur në rrjetin e përdoruesve. Të dhënat përditësohen edhe në rastin që përdoruesi apo agjenti janë offline, duke



	<p>u sinkronizuar menjëherë sapo bien në kontakt me serverin. Disa nga vecoritë:</p> <ul style="list-style-type: none">• Kontroll dhe auditim i rrjedhes së informacioneve në shumë kanale komunikimi (pajisje të jashtme, email, kanale mesazhesh, cloud drives, web).• Zbulim i mospërpuethshmërisë me standarde të tipit GDPR, PCI-DSS e të ngjashme• Auditim i përdorimit të resurseve të tipit workspace: pajisje, aplikacione, periferike• Mbështetje për klasifikim të kontentit (informacionit të skedarëve dhe emaileve) bazuar në inspektimin e tij dhe në rregulla e template të gatshëm• Mbrojtje e rrjedhjes së informacionit në pajisje fundore• Mbrojtje dhe menaxhim i kalimit të informacionit nga pajisjet fundore në periferike lokale apo në rrjet• Klasifikim i informacionit bazuar në origjinë, tip skedari apo flow.• Mbështetje për përdorimin e Sistemeve të avancuar të dedikuara të klasifikimit të informacionit, përmes përdorimit të metadatave të gjeneruara nga këto sisteme• Krijimi i zonave perimetrale të sigurisë së informacionit, për të bërë me të thjeshtë përdorimin e politikave të mbrojtjes• Detektim i qëllimit dhe përdorimit të resurseve të ambjentit të punës.• Të dhëna dhe informacion mbi trafikun web, portale, media sociale, email dhe kanale të tjera komunikimi.• Gjenerim të raporteve dhe lajmërimi në kohe reale për aktivitetin e përdoruesve.• Informacion mbi trendin e sjelljes dhe përdorimit të resurseve në kohë për përdoruesit.• Informacion statistikor mbi kohën e punës së përdoruesve• Mbrojtje e informacionit ne cloud (dropbox, google drive, onedrive etj)
Garancia dhe shërbimet e prodhuesit	<p>Të ketë të përfshirë licensën për shërbimet me vlefshmëri për një periudhë 1 (një) vjecare, përfshirë mbështetjen e prodhuesit.</p> <p>Të jetë i integrueshëm me pajisjen Firewall NG për përdorim të metadatave të gjeneruara nga sistemi për skedarët dhe menaxhim të këtyre skedarëve nga Firewall-i.</p>



* Në analizën e biznesit do të përcaktohen në detaje të gjitha kërkesat dhe realizimi i tyre

7. Vlerësimi i cenueshmerise, Vulnerabilitetet si dhe ekspozimit kundrejt risqeve kibernetike per te dhenat dhe sistemet IT

OSHEE kërkon të vlerësojë vulnerabilitetet si dhe ekspozimet kundrejt risqeve kibernetike për të dhënat dhe sistemet IT, duke siguruar një kornizë të fortë të Qeverisjes së Sigurisë së Informacionit, përputhshmërinë me kërkesat rregullatore, zvogëlon rreziqet dhe përmirëson qëndrueshmërinë e përgjithshme të sigurisë të organizatës.

1. Analiza e Situatës Aktuale

Sektori i energjisë përballlet me sfida të mëdha kibernetike, përfshirë:

- Rritjen e frekuencës dhe sofistikimit të sulmeve kibernetike.
- Kërkesat e repta rregullatore dhe standardet.
- Nevoja për të siguruar një infrastrukturë komplekse dhe të ndërlidhur.

2. Sfida Specifike për Kompaninë

Për OSHEE GROUP, shqetësimet kryesore përfshijnë:

- Mbrojtjen e infrastrukturës kritike nga kërcënimet kibernetike.
- Sigurimi i përputhshmërisë me standardet e industrisë (p.sh., ISO/IEC 27001).
- Mbrojtja e të dhënave të ndjeshme të klientëve dhe operacioneve.
- Kryerja e një vlerësimi të plotë të rrezikut për të identifikuar dhe prioritarizuar rreziqet e sigurisë konform Standartit ISO 27005 ose Metodologjise EBIOS.
- Zhvillimi dhe zbatimi i strategjive të zvogëlimit të rrezikut.
- Rishikimi i politikave, procedurave për të reflektuar kërcënimet dhe ndryshimet rregullatore.
- Zhvillimi dhe Zbatimi i procedurave për fortësimin e sistemeve (hardening guides)
- Krijimi dhe zbatimi i procedurave për fortësimin e sistemeve duke përfshirë sistemet operative, pajisjet e rrjetit duke u bazuar mbi NIST CIS Benchmarks.
- Vlerësimi i konformiteti sipas këtyre benchmark në mënyrë të automatizuar.
- Sigurimi i përputhshmërisë me rregulloret dhe standardet përkatëse (p.sh., ISO/IEC 27001).
- Identifikimi i vulnerabiliteteve në perimetrin e brendshëm dhe të jashtëm.
- Kryerja e nje skanimit të sisteme në perimetrin e brendshëm duke përdorur skanime automatike dhe manuale.
- Kategorizimi i vulnerabiliteteve.
- Hartim plani për rregullimin e vulnerabiliteteve.

3. Detajet e shërbimeve të kërkuara



Duke marrë parasysh perimetrin e provës hibride, i përbërë pjesërisht nga pajisje fizike/virtuale dhe pjesërisht nga aplikacione, tre lloje aktivitetesh duhet të ofrohen në detaje, të kryera nga testues të certifikuar të depërtimit:

- Vlerësimi i cenueshmërisë
- Testimi i penetrimit të aplikacionit në ueb
- Analiza & Raportimi

Vlerësimi i cenueshmërisë duhet të konsistojë në skanimin aktiv të cenueshmërisë së të gjitha pajisjeve (fizike/virtuale) dhe rrjedhimisht të portave, shërbimeve, programeve ndërlidhëse dhe sistemeve operative që lidhen me sistemet dhe pajisjet e rrjetit të përfshira në perimetrin e rrjetit të brendshëm të OSHEE.

Skanimi i kryer duhet të ketë qëllimin:

- Identifikoni sistemet aktive
- Gjurimi portave të hapura TCP/UDP për shërbimet që dëgjojnë në to (p.sh.: porta 80 TCP -> HTTP -> serveri në internet)
- Identifikoni shërbimet e arritshme (p.sh.: aplikacionet në internet, ssh, telnet, smtp etj...)
- Testoni shërbimet e zbuluara kundër bazës së të dhënave të dobësive të njohura (CVE)
- Në rast skanimi të vërtetuar, hyni në sistemet e skanuara dhe kryeni kërkime lokale (p.sh.: statusi i korrigjimit, versioni i OS etj...)
- Identifikoni dobësitë e dyshuara bazuar në përgjigjet e ofruara nga sistemi
- Bazuar në karakteristikat e pikave kritike, caktoni një nivel rreziku për çdo cenueshmëri, duke i klasifikuar dhe renditur ato sipas nivelit të rrezikut
- Bazuar në dobësitë e gjetura, identifikoni korrigjimet përkatëse (p.sh.: aplikoni një patch etj...)

Prandaj, vlerësimi i cenueshmërisë do të duhet të përbëhet nga një aktivitet kryesisht i automatizuar dhe i kryer përmes një skaneri të posaçëm i ngarkuar për identifikimin e dobësive. Do të ofrohen kredencialet e aksesit në sisteme dhe shërbime, skanimi duhet të kryhet në një formë të vërtetuar, d.m.th. duke hyrë në sistemin e skanuar dhe për rrjedhojë duke kryer teste lokale, më të thella dhe të besueshme.

Testi i penetrimit të aplikacionit në ueb përbën një nën-kategori të saktë të testit të penetrimit më gjenerik dhe i referohet analizës specifike të aplikacioneve në ueb. Aplikacionet e brendshme të



ueb-it do të testohen pjesërisht manualisht dhe pjesërisht duke përdorur skanerë të automatizuar, me qëllimin kryesor për të verifikuar nëse aplikacioni është projektuar dhe vendosur në një mënyrë të sigurt.

Në veçanti, për sa i përket aplikacioneve në internet, ato duhet të testohen sipas metodologjisë OWASP, duke ndjekur të gjithë zinxhirin e testeve të përshkruara në «Udhëzuesin e Testimit të Sigurisë së Uebit OWASP».

Testimi i aplikacionit nuk duhet të kufizohet në - megjithëse thelbësor - të ashtuquajturat TOP 10 nga dobësitë më të rrezikshme dhe më të përhapura të uebit, që duhet të shtrihet në të gjitha makro-kategoritë themelore të kontrollit, si p.sh.: menaxhimi i vendosjes, menaxhimi i identitetit, vërtetimi, autorizimi, menaxhimi i sesioneve etj.

Testimi për penetrimin e sistemeve mund të përmbledhet në fazat e mëposhtme:

- Përcaktimi i perimetrit që dëshirohet të mbrohet, pra asetet. Masat e sigurisë të aplikuara për këto asetet përbëjnë kontrollet që do të testohen për të identifikuar kufizimet e tyre.
- Identifikimi i fushës së angazhimit, d.m.th mekanizmat, proceset dhe shërbimet mbrojtëse që rrotullohen rreth aseteve.
- Identifikimi i gjithçka që është jashtë zonës së angazhimit dhe që është megjithatë e nevojshme për të garantuar funksionimin e aseteve, pra edhe faktorët që nuk mund të ndikohen drejtpërdrejt si energjia elektrike, uji, etj.
- Identifikimi i ndërveprimeve të aseteve me brenda dhe jashtë, pra drejtimit e këtyre ndërveprimeve (vektorëve).
- Identifikimi i burimeve të nevojshme për çdo test, sipas mënyrës se si zhvillohet ndërveprimi për asetin, pra kanalin (njerëzor, fizik, me valë, etj.).
- Përcaktimi se çfarë informacioni dëshirohet të merret me testin dhe për rrjedhojë çfarë lloj testi të kryehet (kuti gri, kuti të verbër, etj...).
- Përcaktimi i rregullat e angazhimit dhe sigurimi që testi të përcaktohet në përputhje me to, të njëjtat janë udhëzimet themelore se si të kryhet testi në mënyrë korrekte, si dhe fazat para dhe pas testit.

Rezultati i testit do të jetë matja e sipërfaqes së sulmit, pra pjesa e pambrojtur e zonës së testuar.

Për sa i përket llojit të testit që do të kryhet, është ilustruar në tre lloje bazë që ekzistojnë bazuar në njohuritë e testuesit për objektivin.

Test	Karakteristikat
Blind	Testuesi analizon objektivin pa ndonjë njohuri paraprake për mbrojtjen, asetet ose kanalet. Përkundrazi, objektivi përgatitet për testim, duke ditur paraprakisht të gjitha detajet e testit.
Gray Box	Testuesi skanon objektivin me njohuri të kufizuara për mbrojtjen dhe asetet e tij, si dhe njohuri të plotë të kanaleve.



	Objektivi përgatitet për testim, duke ditur paraprakisht të gjitha detajet e të njëjtit.
Tandem	Si testuesi ashtu edhe objektivi janë të përgatitur për provën, të dy duke i ditur të gjitha detajet paraprakisht.

Aktiviteti i tretë dhe themelor duhet të konsistojë në analizën e rezultateve dhe në hartimin e raporteve të nevojshme.

Rezultatet e skanimeve dhe kontrolleve manuale duhet të analizohen siç duhet dhe këto analiza do të rrjedhin në raporte të veçanta të cilat duhet të ilustronë me shumë detaje:

- Testet e kryera (me të gjithë informacionin e nevojshëm për të kuptuar se çfarë është testuar dhe si)
- Rezultatet e marra (të përshkruara në terma të kuptueshëm)
- Niveli i rrezikut të identifikuar për çdo problem
- Rekomandime në lidhje me veprimet korrigjuese që duhet të zbatohen, me tregues të prioritetit relativ për shkak të ashpërsisë së kërcënimit dhe lehtësisë së zgjidhjes së të njëjtit

Prandaj, aktivitetet e kryera duhet të prodhojnë një vlerësim të plotë dhe në kohë të rrezikut të infrastrukturës së treguar të TIK (identifikimi i rrezikut, analiza e rrezikut dhe vlerësimi i tyre -> cilat të pranohen dhe cilat të zbuten) si dhe një plan të detajuar të trajtimit të rrezikut (si të zbutur rreziqet e papranueshme, me çfarë prioriteti dhe brenda çfarë kohe) që OSHEE mund të përdorë për t'u marrë me kërcënimet e identifikuar, të vërtetuara dhe të papranueshme.

Të dorëzueshme

Ofertuesi do të jetë përgjegjës për prodhimin e produkteve të mëposhtme si pjesë e fazës së dytë:

Raporti AS-IS

Duke ilustruar rezultatin e vlerësimit të kryer dhe, rrjedhimisht, situatën “siç është” në lidhje me infrastrukturën e rrjetit dhe kontrollet e sigurisë në vend, së bashku me nivelin e maturimit të tyre.

Në lidhje me raportimin, në veçanti, duhet të përpunohen dhe dorëzohen sa vijon - për çdo aktivitet:

- Një raport i përgjithshëm, që përmban një pamje globale të rezultateve të analizave të kryera, dhe për rrjedhojë statistikën e përgjithshme që do të përshkruajnë - në një nivel të lartë - statusin e përgjithshëm të sigurisë të zbuluar (sasia e dobësive të zbuluara, përqindja e shpërndarjes së tyre midis klasave të ndryshme të rrezikut, analiza e përgjithshme e



sistemeve operative të zbuluara, përmbledhje ekzekutive me rezultatet kryesore që dolën, OSHEEet më problematike, etj.) dhe testet e kryera

- Një raport i detajuar, që përmban listën dhe përshkrimin e të gjitha dobësive të identifikuara për çdo sistem të skanuar, me rekomandimet përkatëse për zbutjen
- Një plan trajtimi i rrezikut që përmban prioritizimin e rreziqeve të identifikuara (dhe të vërtetuara) dhe rrjedhimisht veprimet e rekomanduara korrigjuese, me kohën dhe prioritetet relative.

Raporti i Vlerësimit të Cenueshmërisë

Ilustrimi i dobësive dhe konfigurimeve të gabuara - të renditura sipas ashpërsisë dhe ndikimit të tyre - të gjetura në rrjetin e jashtëm dhe të brendshëm të OSHEE, shoqëruar me shpjegimin e dobësive, nivelin e rrezikut, analizën e ndikimit, zgjidhjet e rekomanduara dhe referenca të dobishme.

Raporti i analizës së rrezikut

Duke ilustruar rezultatin e procesit të identifikimit dhe vlerësimit të rrezikut të kryer në lidhje me OSHEE.

Rreziqet e identifikuara do të renditen sipas ashpërsisë së tyre dhe raporti duhet të përmbajë të gjithë informacionin dhe analizën e nevojshme rreth tyre, në mënyrë që të bëhet e qartë niveli i ekspozimit ndaj rrezikut të OSHEE.

Trajtimi i rrezikut

Faza e tretë ka të bëjë me përcaktimin e një objektivi të qartë për programin tonë të sigurisë kibernetike, duke detajuar veçoritë e programit dhe duke vendosur qëllimet që do të arrijmë.

Ofertuesi duhet të fillojë duke parashikuar një gjendje të ardhshme ideale për programin tonë të sigurisë kibernetike, më pas të përdorë rezultatet e fazës së dytë për të identifikuar boshllëqet kritike midis së sotmes dhe gjendjes së ardhshme të dëshiruar. Gjatë kësaj faze e cila do të kulmojë me hartimin e një plani gjithëpërfshirës për sigurinë kibernetike i cili synon të jetë dokumenti udhëzues i OSHEE për hartimin, zbatimin dhe zhvillimin e programit të sigurisë kibernetike.

Këtu Ofertuesi tregon nga "çfarë duhet" deri tek "si të arrihet atje". Kjo detyrë ka dy pjesë:

- Ofertuesi duhet të shqyrtojë situatën ashtu siç është dhe rreziqet e identifikuara dhe të vlerësuara.
- Për çdo mangësi që paraqet rrezik të lartë, Ofertuesi do të identifikojë dhe shqyrtojë opsione të shumta për zgjidhjen e mangësive. Këto opsione do të jenë një përzierje



iniciativash teknike dhe programe, secila prej të cilave mund të zbatohet për më shumë se një "boshllëk".

Ofruesi do të përdorë rezultatet e vlerësimit të rrezikut për të zhvilluar një grup rekomandimesh të nivelit të lartë për gjendjen e synuar dhe mënyrën e zbatimit. Kjo do të përfshijë një grup prej 3-5 qëllimesh të shpejta që mund të zbatohen në afat të shkurtër (brenda 6-12 muajve), si dhe rekomandime afatgjata (12 + muaj). Rezultati përfundimtar i kësaj detyre do të jetë një Plan Trajtimi i Rrezikut.

Veprimet e propozuara të sigurisë duhet të jenë në përputhje dhe të frymëzuara me kontrollet e sigurisë të rekomanduara në të njëjtat standarde sigurie të përdorura për të kryer fazën e vlerësimit dhe për të vlerësuar rreziqet ekzistuese.

Të dorëzueshme

1. Plani i trajtimit të rrezikut: që përmban shpjegimin, ndikimin dhe arsyetimet e veprimeve të propozuara të nevojshme për të zbutur rreziqet e identifikuara gjatë fazës së vlerësimit. Plani duhet të përfshijë nisma afatshkurtra dhe afatgjata për të paktën tre vjet me elementë të qartë dhe renditje, procese dhe teknologji të nevojshme në programin e sigurisë. Ofruesi përcakton hapat specifikë dhe të zbatueshëm që do të drejtojnë një program të integruar të sigurisë kibernetike, duke përdorur rezultatet nga faza e vlerësimit për të zhvilluar një grup të nivelit të lartë të kushteve të synuara, rekomandimeve dhe udhëzimeve për zbatim. Ofruesi do të përfshijë një grup prej 3-5 pikash të shpejta që mund të zbatohen në afat të shkurtër (brenda 6-12 muajve) si dhe rekomandime afatgjata (12+ muaj). Produkti përfundimtar i kësaj detyre do të jetë një grup veprimesh, kontrollesh, zgjidhjesh, politikash, procedurash dhe procesesh të nevojshme për të arritur qëllimin e projektit.

* Në analizën e biznesit do të përcaktohen në detaje të gjitha kërkesat dhe realizimi i tyre

8. Instalimi dhe konfigurimi

Shërbimet e instalimit dhe konfigurimit përfshijnë konfigurimin e rrjetit dhe parametrave të sigurisë, instalimin dhe konfigurimin e sistemeve specifike për nevojat e Autoritetit, si dhe kryerjen e testeve për të siguruar funksionimin korrekt të të gjitha komponentëve.

9. Trajnime

Trajnimi ka synim që të familjarizojë stafin e OSHEE me infrastrukturën e re, sistemet e përfshira të sigurisë, monitorimin e tyre, troubleshoot fillestar për problematika të mundshme.



10. Mirembajtja

Shërbimi i mirëmbajtjes do të kryhet në nivel **parandalues** (preventive), duke plotësuar dhe zbatuar të gjitha kushtet dhe sugjerimet e prodhuesve të pajisjeve *hardware* dhe komponentëve *software* si dhe kushtet e nivelit të shërbimit të mirëmbajtjes të hartuara nga Autoriteti Kontraktor.

Shërbimi i mirëmbajtjes përfshin si më poshtë:

- Ruajtjen e nivelit të performancës në tërësi të sistemit, në përputhje me parametrat e vendosur dhe testuar në përfundim të fazës së zbatimit por duke vlerësuar dhe shkallen normale të amortizimit , përgjatë të gjithë periudhës së kontraktuar për shërbimin e mirëmbajtjes;
- Kontrollin vizual në vend për dëmtime të dukshme, të të gjithë elementeve fizike, të dukshëm ose lehtësisht të aksesueshëm, të sistemit, çdo tre (3) muaj kalendarike;
- Kontrollin e parametrave të performancës të pajisjeve *hardware* pjese e sistemit, çdo tre (3) muaj kalendarike;
- Kontrollin, gjatë vizitave periodike, të mënyrës së përdorimit të pajisjeve *hardware* dhe komponentëve *software*, për zbatim të plotë kushteve të garancisë, kushteve të shërbimit të suportit, vlefshmërinë dhe pajtueshmërinë me kushtet e licencave dhe raportimin për sa më sipër të çdo rast konstatimi të moszbatimit ose keqpërdorimit;
- Raportimi me email i çdo kontrolli periodik të elementeve fizikë dhe pajisjeve *hardware* sipas listës me poshtë:

Kushtet e nivelit të shërbimit të mirëmbajtjes (SLA)

Autoriteti Kontraktor kërkon plotësimin e kushteve për nivelin e shërbimit të mirëmbajtjes sipas pikave më poshtë:

- Disponueshmëria e sistemit

Sistemi do të jetë i disponueshëm, funksional dhe i aksesueshëm nga përdoruesit, pa pasur defekte 99.9% të kohës, duke përfshirë të gjithë pajisjet *hardware*, komponentët *software*.

Përfshirë bëjnë rastet kur disponueshmëria ndërpritet për shkak jo për faj të ofruesit të shërbimit. Përfshirë bëjnë gjithashtu rastet kur disponueshmëria e rrjetit që do të lidhë pajisjet ose shërbimet ndërpritet për shkak të mosfunksionimit të sistemit apo cilësisë së shërbimit të operatorit që do të ofrojë këtë shërbim.

Hapësirat kohore për mirëmbajtje të planifikuara në sistem nuk ndikojnë në matjen e disponueshmërisë.



